

## URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën  
vëzhgim të përhershëm

3 shtator 2014, Prizren

Komunikatë #15

### KOMUNIKATË PËR MEDIA

## Publikohen analiza “Ku është kalldrëmi i Prizrenit?” dhe Harta e shtëpive të vjetra

“EC Ma Ndryshe” në kuadër të projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm” të mërkurën ka prezantuar dy produkte të reja, që trajtojnë identitetin urban dhe trashëgiminë kulturore të qytetit, që ditë-ditës po transformohen, duke i dhënë një pamje tjetër Prizrenit, në kundërshtim me kujtesën kolektive të komunitetit.

Produkti i parë është hulumtimi për kalldrëmin e rrugëve të qytetit të Prizrenit i titulluar “Ku është kalldrëmi i Prizrenit?”, që sjell në pah zhvillimet në raport me këtë material, i cili është zëvendësuar me asfalt, madje edhe në rrethin e parë të Qendrës Historike, pa një debat të mirëfilltë me të gjithë akterët shoqëror.

Produkti i dytë është harta e shtëpive të vjetra të Prizrenit, që është rezultat i një pune të gjatë të dokumentimit të kësaj pjese të trashëgimisë kulturore. Shtëpitë e vjetra (qytetare) të Prizrenit janë kategoria e trashëgimisë kulturore që ka pësuar më së shumti në 15 vitet e fundit. Harta e shtëpive të vjetra është edhe një përpjekje e EC Ma Ndryshe për të apeluar për veprim qytetar dhe institucional për t’i shpëtuar shtëpitë e mbetura. Hartën mund ta shihni në linkun: <http://cdb.io/1qIYO48>.

Në hulumtimin “Ku është kalldrëmi i Prizrenit”, theksohet fakti se Prizreni, si qendër urbane, prej shekujsh është dalluar me karakteristikat arkitektonike të saj, ku qyteti është ndërtuar me materiale tradicionale, në mesin e të cilave kalldrëmi përbën identitetin historik të rrugëve e rrugicave të tij. Si i tillë, kalldrëmi i ka dhënë karakter dhe hijeshi shesheve e rrugëve të Prizrenit në të kaluarën, dhe vazhdon ta bëjë këtë edhe sot e kësaj dite në pjesët e mbetura.

Kjo kulturë e shtresuar gjatë shekujve, që është trashëguar deri në ditët e sotme, sipas të gjeturave të hulumtimit është ballafaquar me rrezikun e zhdukjes nga rrugët e Prizrenit për shkak të intervenimeve në emër të zhvillimit të infrastrukturës moderne, duke injoruar në tërësi pjesën identitare të qendrës urbane e historike të qytetit. Madje, pushteti lokal i ka ndërmarrë këto veprime me një qasje autoritative, pa asnjë debat gjithëpërfshirës dhe me bindjen se vetëm establishmenti komunal e di se çka është më e mira për qytetin dhe qytetarët.

Si pasojë e kësaj qasjeje, në vitet e pasluftës, në disa rrugë qendrore të Prizrenit është larguar kalldrëmi dhe është zëvendësuar me asfalt. Në emër të lehtësimit të qarkullimit rrugor të automjeteve është sakrifikuar një nga elementet e identitetit historik të qytetit. Dhe kalldrëmi i larguar, sipas raportit, është depozituar në dy lokacione, me evidencë që nuk shquhej për saktësi. Ndërkohë historia e vendimmarrjes për largimin e kalldrëmit bashkë me projektet e hartuara është shlyer nga memoria institucionale e komunës së Prizrenit shkaku i zjarrit që kishte kapluar ndërtesën e administratës lokale.

Kështu hiri ka mbuluar shumë pyetje që ende mbeten pa përgjigje. Për përgjegjësi e llogaridhënie as që është bërë fjalë. Por ajo çka konstaton raporti, është se Prizrenit i është gjymtuar një pjesë e identitetit, që vështirë se mund të kthehet ndonjëherë.

Prandaj ky raport, më shumë vjen si një kontribut në drejtim të promovimit të vlerës së kalldrëmit, dokumentimit të dëmit që i është shkaktuar qytetit me largimin e tij nga rrugët qendrore, parashtrimit të nevojës për ruajtjen e tij dhe eventualisht hapjen e debatit për rikthimin e këtij materiali në përdorim së paku në zonën qendrore të Prizrenit.

“EC Ma Ndryshe” në korrik të vitit 2013 ka nisur zbatimin e projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”, përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Nevoja për mbikëqyrjen e zhvillimeve në sektorin e urbanizimit ka rrjedhë si pasojë e zhvillimeve të shumta negative gjatë periudhës së pasluftës dhe tranzicionit që janë manifestuar me degradimin urban dhe planifikimin e pabalancuar hapësinor. Projekti do të vazhdoj me monitorimin dhe publikimin e të gjeturave në sektorin e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor, sikurse edhe me adresimin e përgjegjesisë institucionale.

Me nderime,  
Valon Xhabali, Koordinator i Projektit  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren &  
Perandori Dioklecian 14, Kati V, 10000 Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771

## URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën  
vëzhgim të përhershëm

përkrahët financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo